



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 1
02.03.2016

NR. VENDIMI 6
02.03.2017

VENDIM
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë,
në trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

Kryesuese : Iliriana OLLDASHI
Anëtar : Dritan HALLUNAJ
Anëtar : Bib NDRECA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Valbona Demiraj**, sot në datën **02/03/2017, ora 14:00, në Tiranë**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen **nr. 1/9 Akti**, që u përket:

Paditës: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, **përfaqësuar në gjykim nga prokurori Klodjan Braho.**

Me objekt: Konfiskimin e Pasurive.

KUNDËR

Të paditurve: 1-**D.GJ**, i datëlindjes **XX/XX/XXXX**, lindur në **xxxx**, Durrës dhe banues në fshatin **xxxxx**, Komuna **xxxxx**, Durrës, përfaqësuar në këtë gjykim nga përfaqësuesit me prokurë, av. N. F. me nr. License profesionale **XXX**, Dhoma e Avokatisë Tiranë dhe av. L. P. , me nr. License profesionale

XXX, Dhoma e Avokatisë Durrës.

2-Personit Juridik: Shoqëria “XXXXX” Sh.p.k., me Nr. KXXXXXXXXXX Nipti, me seli në Durrës, me administator D.GJ dhe B. XXXXX, përfaqësuar në këtë gjykim nga përfaqësuesit me prokurë, av. N. F. me nr. License profesionale XXX, Dhoma e Avokatisë Tiranë dhe av. L. P. , me nr. License profesionale XXX, Dhoma e Avokatisë Durrës.

Baza ligjore: Ligji nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në prani të: prokurorit Klodjan Braho që kërkoi:

I. Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasit D.GJ, të përshkruara si më poshtë:

1. Pasuria nr. XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 6949 m² truall dhe 2012.7 m² ndërtesë, kompleks shërbimesh “XXXXX”, ndodhur në Durrës;

2. Pasuria nr. XXX/X, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XX, me sipërfaqe 1800 m² truall dhe 140 m² ndërtesë 2+1/2 kat, ndodhur në Durrës;

3. Pasuria nr. XX/XXX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5090 m² tokë arë, ndodhur në Durrës;

4. Pasuria nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5520 m² truall, ndodhur në Durrës;

5. Pasuria nr. XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 4639 m² tokë arë, ndodhur në Durrës;

6. Pasuria nr. XX/X, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 1247 m² truall dhe 230+710 m² ndërtesë, ndodhur në Durrës;

7. Pasuria nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 928 m² truall dhe 229 m² ndërtesë dy kate, ndodhur në Durrës;

8. Pasuria nr. XX/XXX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5090 m² tokë arë, ndodhur në Durrës;

9. Shoqëria “XXXXX” sh.p.k me nr. Nipti KXXXXXXXXXX, së bashku me të gjitha asetet e saj.

II. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të ngarkohet Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë

së Financave Tiranë, administratori Z.Skënder Met'hasani.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimore Durrës.

IV. Shpenzimet procedurale t'i ngarkohen shtetasit D.GJ.

Përfaqësuesve të të paditurve D.GJ dhe "XXXXX" sh.p.k, av. N. F. dhe av. L. P. të cilët kërkuan: Rrëzimin si të pabazuar të kërkesës për konfiskimin e pasurive, për shkak të ligjshmërisë së prejardhjes së tyre.

Kjo gjykatë pasi dëgjoi kërkimet e ndërgjyqësave dhe shqyrtoi provat e këtij gjykimi në tërësinë e tyre :

VËREN se

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesë-padinë me objekt konfiskimin e pasurive në pronësi të të paditurve D.GJ dhe "XXXXX" sh.p.k, me administrator shtetasin D.GJ e konkretisht:

1-Pasuria nr.XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 6949 m² truall dhe 2012.7 m² ndërtesë, kompleks shërbimesh "XXXXX", ndodhur në Sallmone, Durrës.

2-Pasuria nr. XXX/X, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XX, me sipërfaqe 1800 m² truall dhe 140 m² ndërtesë 2+1/2 kat, ndodhur në Sallmone, Durrës.

3-Pasuria nr. XX/XXX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5090 m², tokë arë, ndodhur në Sallmone, Durrës.

4- Pasuria nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5520 m² truall, ndodhur në Sallmone, Durrës.

5-Pasuria nr. XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 4639 m² tokë arë, ndodhur në Sallmone, Durrës.

6- Pasuria nr. XX/X, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 1247 m² truall dhe 230 m²+710 m² ndërtesë, ndodhur në Sallmone, Durrës.

7- Pasuria nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 928 m² truall dhe 229 m² ndërtesë dy kate, ndodhur në Sallmone, Durrës.

8- Pasuria nr. XX/XXX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5090 m² tokë arë, ndodhur në Sallmone, Durrës.

9- Shoqëria "XXXXX"sh.p.k me Nipt KXXXXXXXXXX, së bashku me të gjitha

asetet e saj.

Kërkesë-padia për konfiskimin e këtyre pasurive është bërë nga pala

paditëse Prokuroria për Krime të Rënda, mbi pretendimin se ka dyshime të arsyeshme, për pjesëmarrjen e të paditurit D.GJ në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr.10192, datë 03/12/2009 dhe vlera e pasurive objekt i këtij gjykimi të zotëruara prej tij nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara prej tij dhe si të tilla nuk justifikohet prejardhja e ligjshme e tyre.

Përfaqësuesit e të paditurve av. N. F. dhe av. L. P. e kundërshtuan konfiskimin e pasurive të zotëruara prej të mbrojturve prej tyre duke pretenduar ligjshmërinë e prejardhjes dhe justifikimin e tyre me të ardhurat e ligjshme të përfituara nga veprimtaritë ekonomike të shtetasit D.GJ, shitja e makinerive të një zdrukthtarie shtetasit A.H dhe hua të marra nga shtetasit A.G, G.H dhe SH.K.

Rrethana procedurale:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rregjistruar procedimin pasuror Nr.07, në datë 28/07/2015, në ngarkim të shtetasit D (D) XXXXX, ndryshe I.D, lindur me XX/XX/XXXX, në Shijak, si person i dënuar nga organet gjyqësore kompetente, në Itali, me 7 vjet e 6 muaj burgim, për kryerjen e veprave penale të bashkëpunimit në organizatë kriminale, me qëllim favorizimin e emigracionit të paligjshëm dhe shfrytëzimin e prostitucionit, të parashikuara nga legjislacioni penal italian dhe po ashtu edhe nga Kodi Penal Shqiptar (nenet 114 dhe 110/a të tij) dhe i hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për llogari të procedimit penal Nr.1279/2012, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Mbi kërkesën e Prokurorisë për Krime të Rënda, bazuar në Ligjin nr. 10192, datë 03/12/2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë (më poshtë referimi për këtë ligj do të jetë “Ligji parandalues”) Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë (gjyqtarja e vetme) me vendimin nr. 18 datë 05/08/2015 ka vendosur masën e sekuestros për pasuritë e mëposhtme:

1. Pasuria me nr. XXX/XX ndodhur në volumn nr. X faqe XXX zk. XXXX me adresë fshati xxxxxxxx, Komuna Xhafzotaj i emërtuar “Kompleks Shërbimesh XXXXX” me sipërfaqe totale 6949 m² sipërfaqe ndërtimi 2012, 7 m² i përbërë nga një objekt i formës tre katësh i emërtuar “Supermarket, Bar – Restorant,

Motel” një objekt i formës dy katësh i emërtuar “Disko – Bar – Palester – Sallë Lojrash” një objekt i emërtuar “Bar Kafe”, një pishinë; motel me dy dhoma; një objekt i emëruar “Qendra sportive Kalçeto”; një objekt magazinë i formës një katësh.

2. Pasuria me Nr. XXX/X vol.X fq.XX ne zk. XXXX pemishte + truall + ndertesë me sipërfaqe 1800 m² ndodhur ne xxxxxx, Xhafzotaj, e blerë në datë 29/09/2006 në shumën 210.000 lekë shtetasit L. e I. XXXXX (nëna dhe babai i D.).

3. Pasuria nr. XX/XXX vol. XX fq. XX ne zk. XXXX arë me sipërfaqe 5090 m² ndodhur ne Sallmone, Shijak me datë regjistrimi 02/09/2009.

4. Pasuria me nr. XX/XX vol. XX fq.XX zk. XXXX arë me sipërfaqe 5520 m² ndodhur ne Sallmone, Shijak me datë regjistrimi 02/09/2009.

5. Pasuria nr. XXX/XX vol. X fq. XXX zk. 3102 toke arë ndodhur ne Qerret Katund i Ri me sipërfaqe 1546 m² blerë në datë 13/06/2008 nga shtetasi Q.M për shumën 516.364 lekë.

6. Pasuria me nr. XX/X vol. X fq XXX zk XXXX ndërtesë + truall me sipërfaqe 1247 m² dhe sipërfaqe ndërtese 230 m² ndodhur në Sallmone Shijak blerë në datë 07/11/2006 në shumën 1.900. 000 lekë nga shoqëria “P” Sh. A me qendër në Tiranë ku ndodhet e ngritur një godinë shërbimi me dy kate + bodrum sipërfaqe bodrumi 147 m² sipërfaqe kati 710 m² për të cilën është dhënë leje legalizimi.

7. Pasuria nr. XX/XX vol. X fq. XX zona kadastrale nr. XXXX me sipërfaqe 3110 m² ndodhur ne Sallmone Shijak me datë regjistrimi 02/04/2009.

8. Pasuria nr. XX/XX vol. XX fq. XX zona kadastrale nr. XXXX ndodhur në Xhafzotaj me sipërfaqe 982 m² brenda së cilës ndodhet një ndërtim me sipërfaqe 160 m² dhe truall 400 m².

9. Pasuria nr. XX/XX volumi X fq XXX ndodhur ne zonën kadastrale nr. XXXX me adrese Sallmone – Xhafzotaj, pasuri toke arë, me sipërfaqe 3700 m² indeks të hartës X XX – XX (XXX – X) fituar me kontratën nr. XXXX rep/kol XXXX datë 21/03/2009.

10. Pasuria nr. XX/X volumi X, fq XX ndodhur në zonën kadastrale nr. XXXX me adrese Sallmone – Xhafzotaj toke arë me sipërfaqe 1980 m² me indeks të hartës X XX – XX (XXX – X) fituar me kontratën nr. XXXX rep/kol

XXXX, datë

21/03/2009

11. Shoqëria "XXXXX" sh.p.k me numër nipti XXXXXXXXXXXX së bashku me asetet e saj.

Për disa nga gabimet materiale, lidhur me numrat e pasurive Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar ndreqjen e tyre dhe sekuestrimin e pasurive sipas numërtimit real të tyre.

Kjo gjykatë si gjykata që gjykonte çështjen në themel të saj ka pranuar dhe këtë kërkim duke ndrequr gabimet materiale dhe sekuestruar pasuritë, vendim i ndryshuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, arsye për të cilat jo të gjitha pasuritë objekt konfiskimi janë në gjendje sekuestroje.

Gjatë gjykimit, pala paditëse ka rregulluar ndërgjyqësinë duke futur në këtë gjykim si të paditur dhe shoqërinë "XXXXX" sh.p.k, si person juridik, me përfaqësues ligjor të saj të paditurin D.GJ.

Të paditurit kanë kërkuar në këtë gjykim, pyetjen si dëshmitarë të shtetasve A.G, A.H dhe G.H, kërkim i pranuar nga kjo gjykatë, pa ju dhënë ndonjë cilësi ndërgjyqëse, në kushtet kur të paditurit kanë deklaruar se i kishin shlyer detyrimet ndaj tyre.

Gjykimi i kësaj çështje, për shkak të kompleksitetit që paraqiste, periudhës kohore të gjatë që përfshinte në objektin e shqyrtimit të saj, numrit voluminoz të akteve dhe provave të shqyrtuara, nevojës për ekspertë vlerësues dhe kontabilistë, përfundoi në afatin maksimal, një vjeçar të parashikuar për këtë lloj gjykimi nga pika 2 i nenit 23 të ligjit parandalues nr.10192 te vitit 2009.

Provat e shqyrtuara në këtë gjykim:

Vendimi nr. 18, datë 05/08/2015 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 61, datë 30/09/2015 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Këto vendime janë vënë në ekzekutim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, shkresat nr.480/1 prot., dt.02/09/2015, nr.482/3 prot., dt.03/09/2015, nr.483/1 prot., dt.03/09/2015.

Shkresa nr.677 datë 16/11/2015 e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara së bashku me praktikën bashkë lidhur, mbi pasuritë e paluajtshme të sekuestruara dhe atyre që janë bashkuar. Me anë të kësaj shkrese është plotësuar informacioni mbi pasuritë me nr.XX/XX, volumi X, faqe XX, zona kadastrale nr.XXXX, me sipërfaqe 3110 m², dhe pasuria nr.XX/X,

volume X, faqe XX, zona kadastrale nr.XXXX, me sipërfaqe 1980 m², janë bashkuar në një pasuri të vetme, në pasurinë me nr. XX/XXX, volumi XX, faqe XX, zona kadastrale nr.XXXX, me sipërfaqe 5090 m². Po kështu, sipas kësaj shkrese, pasuria nr.XXX/XX volum nr. X, faqe XXX, zk.XXXX me adresë Fshati Sallmone, Komuna Xhafzotaj, - “Kompleks Shërbimesh “XXXXX“ me sipërfaqe ndërtimore prej 6949 m² ka numrin e pasurisë nr.XXX/XX vol.X, faqe XXX zk.XXXX, arë me sipërfaqe 6949 m², me adresë Fsh.Sallmone, Komuna Xhafzotaj, - “Kompleks Shërbimesh “XXXXX”, dhe për këtë arsye nuk është bërë ekzekutimi i vendimit nr.18 datë 05/08/2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për shkak të ndryshimit të numrit të këtyre pasurive.

Shkresa nr.795 datë 22/12/2015 e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara së bashku me praktikën bashkëlidhur. Informacion mbi ekzekutimin.

Sipas kësaj shkrese, informohet paditësi se nuk është bërë ekzekutimi i pikës 11 të vendimit nr.18 datë 05/08/2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi shoqëria “XXXXX” sh.p.k ka numër NIPTI sekondar XXXXXXXXXXXX dhe kompleksi “XXXXX” ka numër NIPTI XXXXXXXXXXXX, pra ka një NIPT sekondar që nuk i disponon numrit të niptit që ndodhet në vendimin e gjykatës për sekuestrim.

Mbi këtë përgjigje prokuroria i është drejtuar kësaj gjykate për ndreqjen e gabimit në vendim, dhe nga gjykata është dhënë vendimi nr.2, datë 08/02/2016 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë me anë të të cilit është vendosur ndreqja e gabimeve të vendimit nr.18, datë 05/08/2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror nr.7 të datës 28/07/2015 për fillimin e procedimit pasuror të Prokurorisë së Përgjithshme, vendimi për regjistrimin e këtij procedimi pasuror shoqëruar nga aktet:

- Shkresë nr.299/6 prot., dt.10/07/2013 e Ministrisë së Drejtësisë, mbi komunikimin e kërkesës së autoriteteve italiane të drejtësisë, me objekt ekstradimin e shtetasit D.GJ;

- Kërkesa me referencë MA-3592-2011-SC-PU, datë 18/06/2013 e Ministrisë së Drejtësisë së Italisë, për ekstradimin e shtetasit shqiptar të mësipërm drejt Italisë, si dhe notën verbale të Ambasadës Italiane në Shqipëri;

- Përshkrimin e fakteve të veprës penale për të cilën akuzohet ky shtetas, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Milanos, Itali;

- Vendimi penal nr.11691/03, datë 04/12/2003 të Gjykatës së Milanos,

Itali, për dënimin e shtetasit shqiptar D.GJ;

– Urdhër për ekzekutimin e vendimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Milanos, Itali;

– Dispozitat ligjore të zbatueshme të kodit penal Italian.

Me anë të këtyre akteve provohet plotësisht fakti se shtetasi D.GJ është dënuar me 10 vjet dhe 6 muaj burgim, për vepra penale që nga ligji penal shqiptar parashikohen si veprat penale “*shfrytëzimi i prostitucionit*” dhe “*trafikimi i personave*”, të parashikuara nga nenet 114 dhe 110/a të Kodit Penal. Fakti penal për të cilën shtetasi D.GJ është dënuar nga autoritetet italiane të drejtësisë, është kryer në vitet 1999-2001.

Shkresa nr.4144/2 prot., dt.05/06/2015 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, bashkëlidhur vendimi nr.125, datë 17/03/2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për vendosjen e masës së sekuestros preventive të pasurisë nr.XXX/XX, volumi X, faqe XXX, zona kadastrale nr.XXXX, ndodhur në fshatin Sallmone, Durrës me anë të të cilit është vendosur sekuestro preventive për kompleksin “XXXXX”, sh.p.k., i cili është dhe objekt i kërkesës për konfiskim, përveç se pasuria është sekuestruar ajo është e dyshuar si një produkt për pastrimin e parave (sekuestro preventive e hequr më pas nga e njëjta gjykatë).

Shkresa me nr.604/1 prot., datë 23/09/2013 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe shkresa kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me nr.16217/1 prot., datë 22/10/2013, sipas kësaj shkrese shoqëria “XXXXX” sh.p.k, me administrator shtetasin D.GJ për periudhën 2006-2013 ka realizuar 64 deklarata doganore importi.

Shkresa me nr.604/5 prot., datë 23/09/2013 drejtuar Qendrës Kombëtare të Liçensimit dhe shkresa kthim përgjigje nga Qendra Kombëtare e Liçensimit me nr.3805/1prot., datë 04/10/2013.

Shkresa me nr.604/10 prot., datë 23/09/2013 drejtuar CEZ Shpërndarje Sh.a dhe shkresa kthim përgjigje nga CEZ Shpërndarje Sh.a me nr.18181/1 prot., datë 02/11/2013.

Të dhëna mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike të shtetasit D.GJ dhe familjarëve të tij, mbi bazën e të cilave rezulton se shtetasi D.GJ është abonent në pesë raste i shoqërisë OSHEE-së.

Shkresa nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës me nr.17981/2 prot., datë 23/10/2013. Këto shkresa përmbajnë dokumentacionin e shoqërisë “XXXXX” sh.p.k që përfshijnë:

– Vendimi nr.28671, datë 13/12/2002 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për rregjistrimin e personit juridik “XXXXX” sh.p.k;

- Akti i themelimit të shoqërisë “XXXXX” sh.p.k;
- Statuti i shoqërisë “XXXXX” sh.p.k;
- Vendim nr.28671/3 datë 13/07/2006 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për ndryshimin e ortakëve të shoqërisë dhe për emërimin e administratorit. Në bazë të këtij vendimi shtetasi D.GJ është bërë ortak i vetëm i shoqërisë dhe njëkohësisht administrator i saj.

Shkresë me nr.603 prot., datë 23/09/2013 drejtuar bankave të nivelit të dytë dhe përgjigjet e tyre.

Shkresë me nr.68650 prot., datë 14/10/2013 e Bankës Kombëtare Tregtare BKT.

Shkresë me nr. Ref: 8023/2013 datë 27.09.2013 e Bankes së Kreditit të Shqipërisë.

Shkresë me nr.23943 prot., datë 03.10.2013 e Bankës Credins.

Shkresë me nr.19672/1 prot., datë 03/10/2013 e Bankës Societe Generale Albania.

Shkresë me nr.17882 prot., datë 03/10/2013 e Tirana Bank.

Shkresë me nr.18248/1 prot., datë 30/09/2013 e Raiffeisen Bank.

Shkresë me nr.13/19584/1 prot., datë 01/10/2013 e Intesa Sanpaolo Bank.

Shtetasi D.GJ ka pasur llogari në këtë bankë, në monedhën lekë.

Shkresë me nr.09549 prot., datë 27/09/2013 e Alfa Bank.

Shkresë me nr.OP 16215/1 datë 27/09/2013 e Procredit Bank.

Shkresë me nr. Ref: 635/13 datë 27/09/2013 e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë UBA.

Shkresë me nr.ON-A-9931/2013 datë 26/09/2013 e First Investment Bank Fibank.

Shkresë me nr.012788 prot., datë 30/09/2013 e NBG Bank. Shtetasi D.GJ ka pasur llogari në këtë bankë, në monedhën lekë.

Shkresa me nr.14019/1 prot., datë 27/09/2013 e VENETO BANKA.

Shkresa me nr.1512 prot., datë 27/09/2013 e UNIONBANK.

Shkresa me nr.11324 prot., datë 23/09/2013 e International Commercial Bank.

Shkresa me nr.604/3 prot., datë 23/09/2013 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shkresa kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me nr.9802/4 prot., datë 04.03.2014. Nuk ka rezultuar ndonjë automjet në pronësi të shtetasis D.GJ.

Shkresa nr.9687/1 prot dt.13/07/2016 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe aktet bashkëngjitur kësaj shkrese të procedimit penal nr.1279, viti 2012, si më poshtë:

Shkresë nr.130067/1 prot., dt.07.02.2013 e Bankës Intesa SanPaolo. Sipas shkresës së mësipërme, shoqëria “XXXXX” sh.p.k, me Nipt KXXXXXXXXXX, për periudhën 2002 dhe në vazhdim ka pasur pranë kësaj banke dy llogari bankare, në euro dhe në monedhen lekë me linje kredie të marrë nga ana e shoqërisë tregtare të mësipërme.

Shkresë nr.139621 prot., dt.20/05/2013 e Bankës Intesa San Paolo, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur.

Sipas kësaj shkrese shtetasi A. XXXXX ka pasur të ngurtësuar në llogari bankare shumën 250.000 euro, në vitin 2003, e cila ka qëndruar në këtë gjendje deri në vitin 2006, kur është xhiruar në favor të XXXXX sh.p.k, për zvogëlimin e kredisë.

Shkresa nr.15715 prot., dt.18/12/2012 e Bankës Kombëtare Greke, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj shkrese.

Nga ana e këtij dokumentacioni rezulton se i ndjeri A. XXXXX, ish administrator i shoqërisë “XXXXX” sh.p.k, në datën 14/11/2005 ka marrë një kredi në shumën 1.500.000 lekë, e cila më pas është transferuar tek shtetasi D.GJ.

Ky i fundit gjithashtu më datë 13/07/2007 ka lidhur një kontratë kredie për shumën prej 1.340.000 lekë, me afat 5 vjet.

Urdhër për rregjistrimin e procedimit penal datë 10/08/2012, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, shkresë nr.4968 prot., dt.10.08.2012 e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, informacion për referimin e veprës penale.

Te dhënat lidhur me lëvizjet bankare të shoqërisë “XXXXX” sh.p.k, në llogarinë e saj në bankën Intesa San Paolo.

Procesverbal per këqyrjen dhe marrjen e dokumentave datë 19/02/2015, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur.

Skedat e amortizimit të kredisë.

Kontratë kredie bankare nr.4578 Rep., dhe nr.1018 Kol., datë 18/12/2009, lidhur midis shoqërisë “XXXXX” sh.p.k dhe Intesa San Paolo Bank.

Në kontratë është parashikuar marrja e kredisë në shumën 250.000 euro, për tu përdorur për financimin e pjesëshëm të shumës së investimit.

Kontrate kredie bankare nr.754 Rep., dhe nr.508 Kol., datë 29.04.2011, lidhur midis shoqërisë “XXXXX” sh.p.k dhe Intesa SanPaolo Bank.

Në kontratë është parashikuar marrja e kredise në shumën 250.000 euro, për tu përdorur për mbylljen e kredisë overdraft me afat prane së njejtës bankë.

Skedat e amortizimit të kredisë.

Shkresë nr.XXX/X prot., dt.16.02.2014 e Z.V.Rr.P.P Durrës, bashkëlidhur kartelat e pasurive të paluajtshme:

Pasurisë nr.XXX/XX, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XXX, në emër të D.GJ;

Pasurisë nr.XXX/XX, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XXX, në emër të D.GJ;

Pasurisë nr.XX/X, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XXX, në emër të D.GJ;

Pasurisë nr.XXX/X, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XXX, në emër të D.GJ;

Pasurisë nr.XX/XX, zona kadastrale nr.XXXX, volumi XX, faqe XX, në emër të D.GJ;

Pasurisë nr.XX/XXX, zona kadastrale nr.XXXX, volumi XX, faqe XX, në emër të D.GJ;

Shkresë nr.928/1 prot., dt.29.01.2015 e Z.V.Rr.P.P Durrës, bashkë lidhur dokumentacioni i dosjes së pasurisë së paluajtshme të rregjistruar mbi bazën e lejes së legalizimit nr.1574, datë 25.06.2009, në emër të D.GJ.

Me anë të kesaj leje legalizimi është legalizuar sipërfaqeja e ndërtimit prej 2012.7 m² ndërtese dhe 4286.47 m² sipërfaqe tjetër parcele ndërtimore për aktivitet.

Shkrese nr.40/1 prot., dt.12.01.2015 e Drejtorisë Qëndrore të ALUIZNI-T, Tiranë, si dhe dokumentacioni bashkëngjitur kësaj shkrese.

Në këtë dosje legalizimi ndodhen shtatë vetëdeklarime të objekteve informale, të nënshkruara nga shtetasi D.GJ;

Fotografitë e objekteve informale;

Çertifikata e pronësisë, kartela e pasurisë dhe harta treguese, lidhur me pasurinë e paluajtshme nr.XXX/XX, zona kadastrale nr.XXXX, tokë are me sipërfaqe 6949 m², mbi të cilën janë ndërtuar objektet informale;

Leja e legalizimit nr.1574, datë 25.06.2009, në emër të D.GJ;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për vetdeklarimin nr.414 prot., (*objekti magazine 1 kat*), ku vlera e investimit është në shumën 15.263.071 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për

vetdeklarimin nr.415 prot (*objekti supermarket, bar-restorant, motel 3 kate*), ku vlera e investimit është në shumën 79.206.070 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukture, për vetdeklarimin nr.420 prot., (*objekti bar kafe 1 kat*), ku vlera e investimit është në shumën 2.810.086 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për vetdeklarimin nr.417 prot., (*objekti qendra sportive, motel dhe dhoma*), ku vlera e investimit është në shumën 5.234.440 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për vetdeklarimin nr.416 prot., (*objekti disko bar, palester, salle lojrash 2 kate*), ku vlera e investimit është në shumën 22.250.155 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për vetdeklarimin nr.419 prot., (*qendra sportive, kalceto*), ku vlera e investimit është në shumën 37.374.672 lekë;

Formular për llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për vetdeklarimin nr.418 prot., (*objekti qendra sportive, pishine*), ku vlera e investimit është në shumën 10.664.007 lekë;

Vlera totale e investimit të llogaritur si me sipër, është në shumën **172.802.501** lekë.

Shkresë me nr.29 prot., datë 09/01/2014 drejtuar Komunës Xhafzotaj dhe shkresa kthim përgjigje nga Komuna Xhafzotaj me nr.17/1 prot., datë 14/01./2014. (F-2, faqe 218-221). Çertifikatat personale dhe familjare për shtetasin D.GJ

Ekstrakti historik i rregjistrimit të shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k. me Nipt XXXXXXXXXXXX.

Bilancet e shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k.

Deklarate noteriale me nr. 3225 rep., Dhe nr. 3103 kol., datë 04/11/2015 të lëshuar nga shtetasi G.H.

Deklaratë datë 21/10/2015 lëshuar nga shtetasi A.H.
Marrëveshje e lidhur me shtetasin A.G.

Vendim gjyqësor nr. 188 datë 30/06/2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vendimi nr. 10-2015-1886, datë 16.09.2015 i Gjykatës së Apelit Durrës, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 188 datë 30/06/2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vendimi nr. 11-2016-1118 datë 29.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka revokuar masën e sekuestros preventive për pasurinë

XX/X.

Vendimi nr. 10-2016-812 datë 12.04.2016 i Gjykatës së Apelit Durrës, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 11-2016-1118 datë 29/02/2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kontratat e shitblerjeve të pasurive:

- Pasuria – XXX/XX
- Pasuria – XXX/XX
- Pasuria – XXX/XX
- Pasuria – XXX/XX
- Pasuria – XX/XX
- Pasuria – XXX/XX
- Pasuria – XX/X
- Pasuria – XX/xx
- Pasuria – XX/XX
- Pasuria – XX/XXX

Kontrata e blerjes së shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k., nga trashëgimtarët e A.GJ.

Çertifikata e gjendjes familjare të shtetasit L. GJ. me 1 gusht 1991

Akti i marrjes së tokës bujqësore nga shtetasi L. GJ .

Aktet e ekspertimit vlerësues dhe kontabël të kryera gjatë procesit penal, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjykata konstaton se thuajse në gjendjen e provave e akteve me të cilat është pranuar kërkesa për sekuestrim, pa asnjë veprim tjetër të hetimit pasuror, Prokuroria për Krime të Rënda, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën me objekt konfiskimin e pasurive.

Në këtë gjykim, kjo gjykatë mbi konstatimin e mësipërm dhe mbi kërkimet e të paditurve ka pranuar kryerjen e një ekspertimi vlerësues të pasurive dhe një ekspertim kontabël të lëvizjeve financiare, që prej vitit 1999 e deri në momentin e kryerjes së aktit të ekspertimit. Mbi kontestimet kryesisht të palës paditëse, Prokurorisë për Krime të Rënda, për ekspertimet dhe përfundimet e arritura prej tyre, janë realizuar tre shtesa ekspertimesh, pas ekspertimit të parë të paraqitur nga ekspertët: vlerësuesja Diana Bardhi dhe kontabilisti Gëzim Jaupaj.

Kjo gjykatë edhe pse pala paditëse insiston dhe në konkluzionet përfundimtare se metodologjia e përdorur nga ekspertja vlerësuese e pasurive

është e gabuar dhe rrjedhimisht edhe ekspertimi kontabël që bazohet mbi të, vlerëson se për shkak të mungesës së njohurive teknike, nuk mund t'u imponojë dhe as të gjykojë mbi metodologjinë e përdorur prej ekspertëve. Secila nga palët ndërgjyqëse, madje dhe gjykata vetë mund të bëjë llogaritje matematikore dhe të ngrejë vlerësime krahasuese dhe mbi to.

Në vlerësim të fundit eksperti kontabël ka pasqyruar se për shtetasin D.GJ në total rezultojnë: Blerje, investime, shpenzime të tjera të kryera janë 121 514 730 lekë ndërsa burime financimi, të ardhura të tjera etj., 113 375 143 lekë. Mbi sqarimin e fundit të ekspertit kontabël pas pyetjeve se në këtë bilanc nuk janë pasqyruar kthimi i huasë shtetasit A.G në vlera materiale, në vështrim të fundit të tij ky bilanc rezulton pozitiv.

Tabela e aktit të ekspertimit kontabël.

Bilanci perfundimtar për blerjet, investimet dhe shpenzimet e kryera dhe burimet e financimit sipas viteve dhe në total

N. R.	Nr. Pasurise	Pershkrimi	siperfaqe	Vlera ndertimit ose kontrates blerjes, shpenzime të tjera leke.	Burime finan leke
1	xxx/xx	Supermarket 3 kat+magazine 1kat (legalizim nr.1574 date 25.06.2009 akt vl.pasurie dt.25.11.2013 kosto e vitit 1995) nga bashkimi I pasurive:	6949 m2	-	
2		Certifikate pronësie xxx/x kontrate blerje toke are date 16.07.1999 siperfaqe 1980 m2 nga Vathe e M. D.		300,000	
3		Certifikate pronësie xxx/x kontrate blerje toke are date 16.07.199 siperfaqe 2070 m2 nga G. D. ,N. D. ,G. D. ,R. D. vleresuar me kosto ndertimi si me poshte:		500,000	
4		1. Magazina		2,086,000	
5		2. Marketi		17,967,806	
6		Kontrate huamarrje date 21.06.1995, huadhenesi A. G. , huamarresi D. Gj. , ne shumen 22,000,000 leke.			22,000,000
7		Kosto familjare viti 1999		101,028	
8		kthim huaje ne klering sipas deshmise verbale ne gjykate		15,000,000	
		Shuma deri 31,12,1999		35,954,834	22,000,000
9	xxx/xx	Disko+palester2kt, dhoma plazhi ,pishine ,kalcetoetj v.2005 (leje legalizimi nr.1574 date 25.06.2009 akt vleresim pasurie dt.30.11.2013, kosto e ndertimit e viteve 2003- 2005) nga bashkimi I pronave:		-	

10		Prona xxx/xx regj.10.07.2006 kontrate blerje date 16.06.2006 toke are me siperfaqe 1428 m2 nga K.E. ,A.D. .		210,000	
11		xxx/xx regj.03.07.2006 toke are 990 m2 ,kontrate blerje date 14.06.2006 nga SH,K ,Q.I. D.D. xxx/xx regj.03.07.2006 toke are siperfaqe 481 m2 , kontrate blerje date 14.06.2006 blere nga H, F S, G.GJ vleresuar me kosto ndertimi si me poshte:		140,000	
12				70,000	
13		1. Disko - palester		16539124	
14		2. Pishina		3,966,014	
15		3. Fusha sportive		1,384,751	
16		4. Dhoma çveshje		1,888,887	
17		Deklarate blerje makineri e paisje perpunim druri nga shtetasi A.H, shitesi D.GJ date 23 mars 2000 ne vleren 2,300,000 leke.			2,300,000
18	xxx/x	Prona pemishte+truall+ndertese siperfaqe 1800 m2,kontr.blerje date 29.09.2006 nga L dhe I.GJ (blere nga prinderit pa pagese sipas deklarates dt.01.10.2015)	Blere nga familjaret	210,000	
19	13/07/2006	Kontrate shitblerje kuotash shoqeria "GJ " shpk		3,900,000	
20		Akt - marreveshje huaje date 03.02.2006 huadhenes G.H, huamarres D.GJ ne shumen 6,500,000 leke, deklarate e kthimit te kesaj huaje huadhenesit date 28.12.2008 ne shumen 6,500,000 leke.			6,500,000
21		Kosto familjare viti 2000		101,028	
22		Kosto familjare viti 2001		101,028	
23		Kosto familjare viti 2002		101,028	
24		Kosto familjare viti 2003		101,028	
25		Kosto familjare viti 2004		101,028	
26		Kosto familjare viti 2005		114,120	
27		Kosto familjare viti 2006		114,120	
28		Te ardhura nga paga D. Gjviti Viti 2006.			68,192
29		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2007 Kredi bankare overdraft tek NGB Bank date 13.07.2007 ne shumen 1,340,000 leke shume e shlyer me keste deri ne 13 shtator 2012.			406,215
30					1,340,000
31		Kosto familjare viti 2007		114,120	
32		Terhequr nga llogaria "ortake" shoqeria "GJ shpk." viti 2007			13,551,35
		shuma deri 31,12,2007		65,111,110	46,172,85
33	95/132	Toke are me siperfaqe 5090 m2 regjistruar ne date 02.09.2009, nga bashkimi I pasurive:	5090 m2		

34		Prona nr.xx/x kontrate blerje toke are ne date 21.03.2009, siperfaqe 1980 m2 nga M.V dhe M.GJ (familjaret e bleresit), blere pa pagese cash sipas deklarates se familjareve date 01.10.2015)	Blere nga familjaret	929,280	
35		Prona nr. xx/xx kontrate blerje toke are date 20.02.2009 , siperfaqe 3110 m2 nga L.GJ , I.GJ , M.GJ sipas deklarates se bleresve date 01.10.2015 pa pagese cash.	Blere nga familjaret	1,642,080	
36	xx/xx	Toke are me siperfaqe 5520 m2 e regjistruar ne date 02.09.2009, qe rezulton nga bashkimi I pasurive:	5520 m2		
37		prone nr.xx/xx.kontrate blerje toke are date 24.02.2009 me siperfaqe 1820 m2, nga shitesit L.GJ,I.GJ, M.GJ , blere nga familjare te bleresit pa pagese cash sipas deklarates date 01.10.2015.	Blere nga familjaret	960,960	
38		prona nr.xx/xx.kontrate blerje toke are date 21.03.2009 me siperfaqe 3700 m2 nga M.Vdhe M.GJ, familjare te bleresit, pa pagese cash sipas deklarates date 01.10.2015	Blere nga familjaret	1,736,533	
39	xxx/xx	Toke are me siperfaqe 4639 m2, kontrate blerje date 13.06.2008 toke are , regjistruar 4639 m2 blere nga shtetasit Q dhe F.M.	4639 m2	516,364	
40	xx/x	Truall 1247 m2 dhe ndertese dy kate 230 m2 , blere me kontrate blerje date 07.11.2006 nga shoqeria "XXXXXX XXXXX" sha	1247 m2	1,900,000	
41		Ne kete objekt jane kryer punime shtese ndertimi "godine sherbime 2 kat+podrum) 710 m2 ndertuar ne vitin 2007-2008 dhe jane legalizuar me leje legalizimi nr. 39758 date 13.06.2013 , vleresuar me kosto ndertimi.		12,234,858	
42	xxx/x	Toke are me siperfaqe 2800 m2 , kontrate blerje date 24.04.2007 nga shitesi G.TH.	2800 m2	200,000	
43		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2008			472,800
44		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2009			472,800
45		Kosto familjare viti 2008		116,688	
46		Kosto familjare viti 2009		116,688	
47		Terheqje e shumes per zhdemtmet nga Gerdeci 31.07.2008			1,198,460
48		Deklarate kthim huaje date 28.12.2008, hua e narre nga G. H.. sipas akt marrevshjes date 03.02.2006(burime financimi minus)			- 6,500,
49		Terhequr nga llogaria "ortake" shoqeria "Gj shpk." viti 2008			11,567,783
		Terhequr nga llogaria "ortake" shoqeria "Gj			

50		shpk." viti 2009			7,858,279
51		Akt marreveshje huaje date 03.01.2011 huadhenes G.H, huamarres D.GJ , ne shumen 25,000,000 leke			25,000,000
52		Kontrate shitje e prones 328/1 date 06,06,2011 shoqerise "N" shpk,dhe cregjistrim i saj			1,996,400
53		Kontrate huamarrje date 30.07.2011 , huadhenes SH.K, huamarres D.GJ ne shumen 20,000,000 leke.			20,000,000
54		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2010			472,800
55		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2011 Te			472,800
56		ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2012			472,800
57		Kosto familjare viti 2010		116,688	
58		Kosto familjare viti 2011		116,688	
59		Kosto familjare viti 2012		102,288	
60		Terhequr nga llogaria "ortake" shoqeria "Gj shpk." viti 2010			2,318,962
61		Derdhur ne llogarine ortake viti 2011		29,033,361	
		shuma deri 31,12,2012		114,833,586	111,974,74
62	xx/xx	Prona Pemetari+truall 928 m2 ndertese 229 m2 legalizuar me nr.98757 date 10,05,2013 krijuar nga bashkimi I pasurive:			
63		xx/x perfituar me kontrate blerje 07,04,2009 siperfaqe340 m2(truall+ndertese) nga shtetesja P.H		1,962,428	
64		xx/xx perfituar me kontrate blerje 30,05,2009 siperfaqe 450 m2, nga te cilat 200m2 truall dhe 80 m2 ndertese blere nga shitesi P.H.		4,369,210	
65		xx/xx perfituar me kontrate blerje 31,07,2009 pemishte me siperfaqe 138 m2, blere nga shitesit R. I, E.S dhe E.C		42,642	
66		Te ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2013 Te			472,800
67		ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2014 Te			454,800
68		ardhura nga paga D. Gj viti Viti 2015			472,000
69		Kosto familjare viti 2013		102,288	
70		Kosto familjare viti 2014		102,288	
71		Kosto familjare viti 2015		102,288	
		SHUMA TOTALE		121,514,730	113,375,14

Vlerësimi i gjykatës:

Kjo gjykatë mbi të gjitha të dhënat e provave të shqyrtuara në këtë

grykim, kërkesave dhe parashikimeve në ligjin parandalues, nr. 10192, datë 03/12/2009 vlerëson së kërkimi i Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurive që ju përkasin të paditurve D.GJ dhe “XXXXX” sh.p.k me administrator shtetasin D.GJ është pjesërisht i bazuar mbi këtë arsytim:

Së pari, ashtu si edhe në fazën e sekuestrimit të pasurive objekt i këtij grykimi edhe kjo grykatë e gjen të drejtë pretendimin e Prokurorisë për Krime të Rënda se të paditurit D.GJ dhe shoqëria “XXXXX” sh.p.k, si e lidhur me të, janë subjekte të ligjit parandalues nr. 10192 datë 03/12/2009 në zbatim **të nenit 3/1 pikat a & ç dhe nenit 3/2, pika b** të këtij ligji.

Me vendimin datë 02/11/2007 të Grykatës së Apelit, Milano, Itali, shtetasi D.GJ (i paditur në këtë grykim) është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale me qëllim favorizimin e emigracionit të paligjshëm e shfrytëzimin e prostitucionit dhe është dënuar me 10 vjet dhe 6 muaj burgim e ka përfituar ulje në masën prej 3 vjet burgim, nga amnistia e vitit 2006. Në Kodin Penal shqiptar, këto vepra penale janë parashikuar nga nenet 114, 110 dhe 334 të tij.

Gjithashtu, shtetasi D.GJ rezulton person nën hetim edhe në Prokurorinë pranë Grykatës së Rrethit Gryqësor Durrës, për llogari të procedimit penal nr.1279/2012, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Pra nisur nga lloji i veprave penale për të cilat është dënuar nga një autoritet gryqësor i huaj dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe indicje se shtetasi D.GJ është i përfshirë në një veprimtari kriminale të pjesëmarrjes në organizatë kriminale me qëllim favorizimin e emigracionit të paligjshëm e shfrytëzimin e prostitucionit dhe pastrimin e produkteve të veprës penale, ai dhe shoqëria e tij “XXXXX” sh.p.k, si person juridik janë subjekte ndaj pasurive të të cilëve zbatohen masat parandaluese.

Fakti penal për të cilin i padituri D.GJ është dënuar nga autoritetet italiane të drejtësisë është kryer në periudhën kohore që përfshin para vitit 1999, deri në vitin 2001.

Së dyti: Nga aktet dhe provat e paraqitura në këtë grykim, provohet se **pasuritë objekt konfiskimi janë krijuar nga viti 1999 e në vazhdim**, pra janë pasuri të krijuara pas periudhës kur provohet se i padituri D.GJ ka qënë i përfshirë në veprimtari kriminale (objekt zbatimit të ligjit **nr. 10192, datë 03/12/2009, sipas nenit 3/4 të tij**).

Në këto kushte e gjithë pasuria objekt i kërkesës për gjykim, përfshihet në pasuritë që duhet t'u nështrohen rregullave të parashikuara në ligjin parandalues duke patur personat zotërues të saj, të paditurit, barrën e provës të justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, sipas nenit 21/3 të ligjit parandalues.

Pasuritë objekt konfiskimi:

1. Pasuria nr. xxx/xx, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqje 6949 m² truall dhe 2012.7 m² ndërtesë, kompleks shërbimesh "XXXXX", ndodhur në Durrës.

Kjo pasuri është rezultat i bashkimit të disa pasurive konkretisht pasurisë nr.XXX/X, pasurisë nr.XXX/X, pasurisë XXX/XX, pasurisë XXX/XX dhe pasurisë XXX/XX dhe disa ndërtime sipër tyre të legalizuara në vitin 2009 e konkretisht nga një objekt trekatësh i emërtuar "Supermarket, Bar, Restorant Motel", një objekt dykatësh i emërtuar "Disko, Bar, Palestër, Sallë Lojërsh", një objekt njëkatësh i emërtuar "Bar-Kafe", një pishinë, motel me dy dhoma, një objekt i emërtuar "Qendra Sportive, Kalçeto" dhe një objekt i emërtuar "magazinë e formës njëkatëshe".

Pasuritë XXX/X dhe XXX/X janë blerë nga i padituri D.GJ në vitin 1999 me kontratë noteriale provë dokumentare e këtij gjykimi nga shtetasit V. e M.D dhe G.D, N.D etj.

Lidhur me këtë pasuri XXX/XX, që për nga vlera e saj përbën objektin më të madh, i padituri D.GJ, nëpërmjet përfaqësuesve ka pretenduar se ndërtimi i objekteve në të përfshin një periudhë të gjatë kohore dhe disa pjesë të saj magazina dhe marketi janë ndërtuar para vitit 1999 në vitet 1995 dhe 1996, periudha para përfshirjes së të paditurit në veprimtari kriminale.

Ky pretendim mbeti në fazën pretenduese, pa suportuar fazën provuese para kësaj gjykate duke mos u përmbushur prej tyre detyrimi i nenit 21/3 të ligjit parandalues, "barra e provës".

Një nga pretendimet e të paditurve ishte se dokumentimi i shitjes së sipërfaqjeve të tokës e llojit arë mbi të cilin është ndërtuar "Kompleksi XXXXX" ishte bërë në vitin 1999, për shkak se zotëruesit e pronave nuk i kishin rregjistruar para këtij viti pronat e tyre, por ato ishin në posedim të të paditurit disa vite më parë, pretendim që bie në kundërshtim me kartelat e pasurive të paluajtshme të cilat pasqyrojnë se shitësit e këtyre pronave (shtetasit M.D, G.D, etj) i kishin të rregjistruara pronat e tyre që prej vitit 1996 (pra tre vite para përpilimit të akt-shitjeve noteriale). Po ashtu vetë dokumentat e paraqitura nga të paditurit ndër të tjera përmbajnë tre planimetri që mbajnë datën 10/01/1998, në të cilat është projektuar ndërtimi i trarëve dhe kollonave të

objektit market me tre kate, akte shkresorë që rrëzojnë pretendimet e ngritura prej tyre.

Lidhur me burimet e financimit të ndërtimeve i padituri XXXXX ka pretenduar se kanë si të tilla një marrëdhënie huaje në vitin 1995 mes shtetasit A.G si huadhënës dhe D GJ si huamarrës, paraqitur nëpërmjet një shkresë të thjeshtë (jo me akt noterial).

Pavarësisht se kontrata e huasë ne Kodin Civil nuk parashikon detyrimin e formalizimit të saj në një akt noterial, të paditurit, në këtë gjykim të posaçëm kanë detyrimin të provojnë para kësaj gjykate jo vetëm marrëdhënien reale të huasë dhe mundësinë financiarë të huadhënësit në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshje, por edhe kalimin fizikisht të shumës monetare nga huadhënësi tek huamarrësi.

Përveç paraqitjes së shkresës së thjeshtë të huasë dhe pyetjes si dëshmitar të huadhënësit të pretenduar, në këtë gjykim i padituri D.GJ nuk provoi se shtetasi A.G në vitin 1995 dispononte realisht shumën monetare prej 22.000.000 lekësh (që për kohën e pretenduar ka qënë e konsiderueshme) dhe aq më pak kalimin e tyre fizik tek i padituri, me qëllim ndërtimin e objekteve të kompleksit.

Lidhur me objektet e tjera të ndërtuara në kompleksin e shërbimeve “XXXXX” të emërtuara si: një objekt dykatësh i emërtuar “Disko, Bar, Palestër, Sallë Lojërsh”, një objekt njëkatesh i emërtuar “Bar-Kafe”, një pishinë, motel me dy dhoma, një objekt i emërtuar “Qendra Sportive, Kalçeto”, i padituri XXXXX ka pretenduar se këto objekte janë ndërtuar dhe financuar rreth viteve 2003-2005 nga vëllai i tij, shtetasi A. XXXXX, i cili në atë kohë ishte ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “XXXXX” sh.p.k (i paditur në këtë gjykim) dhe pas vdekjes së tij janë zotëruar nga i padituri D.

Edhe ky pretendim i të paditurve mbeti i tillë pa u provuar në gjykatë, madje provat e paraqitura në këtë gjykim provojnë të kundërten, pasi blerjet e bëra jashtë shtetit në këtë periudhë për mobilimet e brendshme dhe sendeve aksesore për kompleksin “XXXXX” edhe pse janë të rregjistruara në emër të shoqërisë “XXXXX” sh.p.k, kanë porositës personalisht të paditurin D.

Lidhur me burimin tjetër të financimit të pretenduar nga të paditurit, shitjen e makinerike të zdrucktarrisë në vitin 2000 shtetasit A.H në shumën 2.300.000 lekë me një shkresë të thjeshtë, në kushtet kur nuk shoqërohet me asnjë të dhënë tjetër konfirmuese nuk plotëson detyrimin e provueshmërisë për të bindur gjykatën se këto makineri kanë ekzistuar, vlerën dhe gjendjen e tyre, aq më tepër që bëhet fjalë për shitje të sendeve të luajtshme,

të cilat nuk mund të rivlerësohen në një tjetër moment.

Në konkluzion të arsyetimit të parashtruar më sipër për pasurinë e parë në radhë dhe vlerë, me nr. XXX/XX, kompleksin “XXXXX”, kjo gjykatë vlerëson se pamjaftueshmëria e akteve dhe provave me vlerë të plotë provuese nga i padituri D.GJ nuk provoi prejardhjen e ligjshme të këtij kompleksi si të truallit ashtu dhe të ndërtimeve të kryera mbi të.

Pasuria shoqëria “XXXXX” sh.p.k me Nipt KXXXXXXXXXX, me seli në Sallmone, Durrës dhe me objekt tregëtim me shumicë dhe pakicë. Import, eksport, hoteleri-turizëm etj., së bashku me të gjitha asetet e saj.

Kjo shoqëri e identifikuar gabim në procesin e sekuestrimit si shoqëria “XXXXX” sh.p.k me **numër nipti XXXXXXXXXXX (jo aktive)**, për shkak të përdorimit të të njëjtit emër, është krijuar dhe rregjistruar në vitin 2002 nga vëllai i të paditurit, shtetasi A. XXXXX, ortak i vetëm dhe administrator i saj.

I padituri D.GJ ka përvetësuar më datë 13/07/2006 nëpërmjet blerjes nga trashëgimtarët ligjor të krijuesit të saj A. XXXXX (Kontratë shitblerje kuotash shoqëria “XXXXX” sh.p.k) këtë shoqëri në vlerën 3.900.000 lekë.

Burimi i financimit të kalimit në pronësi të kësaj shoqërie, sipas të paditurit D.GJ ka qenë deklarata e blerësit A.H dhe marrëveshja e huasë në shumën 6.500.000 lekë nga shtetasi G.H.

Të dy këto burime të pretenduara financimi edhe pse plotësojnë një kriter minimal të hartimit të tyre më një akt të thjeshtë, nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e provueshmërisë para kësaj gjykate, mbi të njëjtin arsyetim të parashtruar dhe më sipër, sipas të cilit të paditurit nuk kanë vetëm detyrimin të deklarojnë personalisht apo të paraqesin në gjykatë deklarimin e personave të lidhur në marrëdhënie detyrimi me ta (në këtë gjykim dëshmitarët A.G, A.H, G.H), por të provojnë se kjo marrëdhënie është reale lidhur me persona fizik, ose juridik që kanë mundësi financiare të provuara se mund ta realizojnë huadhënien, ose çdo lloj marrëveshje tjetër financiare.

Mbi këtë arsyetim, kjo gjykatë vlerëson se i padituri D.GJ nuk provoi financimin e ligjshëm të kësaj blerje dhe prejardhjen e ligjshme të shoqërisë “XXXXX” sh.p.k **me Nipt XXXXXXXXXXX**, me seli në Sallmone, Durrës arsye mbi të cilat, kjo gjykatë pranon sipas nenit **24/1/b** të ligjit parandalues konfiskimin e saj.

Duke konkluduar mbi paligjshmërinë e prejardhjes së shoqërisë “XXXXX” sh.p.k me Nipt XXXXXXXXXXX, kjo gjykatë në mbështetje të ligjit parandalues nr.

10192, datë 03/12/2009 vlerëson se gjithë të ardhurat dhe asetet e saj rrjedhimisht janë objekt konfiskimi dhe nuk ligjërohet prejardhja e tyre edhe pse kjo shoqëri ka qënë aktive dhe me bilanc pozitiv në momentin e zotërimit të saj nga i padituri D.GJ.

Mbi këtë arsyetim të mbështetur në dispozitat e ligjit parandalues dhe qëllimit të tij kjo gjykatë konkludon se nuk justifikohet prejardhja e ligjshme e pasurive me nr. XXX/XX, XX/XX dhe XX/X të poseduara tërësisht nga pronari i tyre, i padituri D.GJ dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009 vendos konfiskimin e tyre.

Kjo gjykatë në mbështetje të dispozitave të ligjit parandalues nr. 10192, datë 03/12/2009, qëllimit të tij, kohës së kryerjes së veprimeve juridike, vlerës së tyre, informalitetit financiar të vendit tonë, lidhjes së ngushtë familjare të personave palë në këto kontrata, pjesëve takuese të të paditurit D.GJ në tokat bujqësore të fituara me ligjin nr. 7501 “Për tokën” konkludon se është i pambështetur në **nenin 24/1 pika “b” të ligjit parandalues** kërkimi i Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e pasurive me nr. XXX/X, nr.XX/XXX dhe XX/XX dhe rrëzon kërkimin për këtë pjesë. Po në këtë moment gjykata çmon të theksojë se pasuria nr. XX/XXX dhe XX/XXX të kërkuara si më vete nga pala paditëse, janë e njëjta pasuri.

Në përfundim në konkluzion të të gjithë arsyetimit të parashtruar më sipër, kjo gjykatë vlerëson së të paditurit D.GJ dhe XXXXX sh.p.k, si person juridik i lidhur me të nuk provuan që pasuritë në zotërim të plotë të të paditurit D.GJ me përjashtim të pasurive me nr. XXX/XX, XX/xx dhe XX/X të cilat kjo gjykatë i përjashtoi nga konfiskimi të kenë prejardhje të ligjshme të provuar si të tillë para kësaj gjykate.

Për çka dhe si u arsyetua më sipër në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03/12/2009, të Kodit të procedurës civile, kjo gjykatë në mbështetje të provave të paraqituara në këtë gjykim dhe pasi krijoi bindjen mbi to:

VENDOSI:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së Prokurorisë për Krime të Rënda.

Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

1- Pasurisë nr. XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 6949 m² truall dhe 2012.7 m² ndërtesë, kompleks shërbimesh “XXXXX”, ndodhur në Durrës.

2- Pasurisë nr. XXX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 4639 m² tokë arë, ndodhur në Durrës.

3- Pasurisë nr. XX/X, zona kadastrale nr. XXXX, volumi X, faqe XXX, me sipërfaqe 1247 m² truall dhe 230 m²+710 m² ndërtesë, ndodhur në Durrës.

4- Pasurisë nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 928 m² truall dhe 229 m² ndërtesë dy kate, ndodhur në Durrës.

5- Shoqërinë “XXXXX” sh.p.k me Nipt KXXXXXXXXXX, me seli në Sallmone, Komuna Xhafzotaj, Durrës së bashku me të gjitha asetet e saj.

Prëzimin e kërkesës për sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

1- Pasurise nr. XXX/X, zona kadastrale nr.XXXX, volumi X, faqe XX, me sipërfaqe 1800 m² truall dhe 140 m² ndërtesë 2+1/2 kat, ndodhur në Sallmone, Komuna Xhafzotaj, Durrës.

2- Pasurisë nr. XX/XXX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5090 m² tokë arë, ndodhur në Sallmone, Komuna Xhafzotaj, Durrës.

3- Pasurisë nr. XX/XX, zona kadastrale nr. XXXX, volumi XX, faqe XX, me sipërfaqe 5520 m² truall, ndodhur në Sallmone, Komuna Xhafzotaj, Durrës.

Revokimin e masës së sekuestros së vendosur me vendimin nr. 18 datë 05/08/ 2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë mbi pasuritë me nr.XXX/X, XX/XXX dhe XX/XX.

Për administrimin dhe përdorimin e pasurive ngarkohet Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, administratori z.Skënder Met’hasani.

Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyrës se Përmbarimit Gjyqësor Durrës.

Urdhërohet sekretaria gjyqësore të njoftojë kopjen e këtij vendimi Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë, si dhe Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Durrës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, brenda afatit ligjor.

U shpall sot në Tiranë, në datën 02/03/2017.

SEKRETARE

Valbona DEMIRAJ

GJYQTARE

Iliriana OLLDASHI

